



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Nr. 178 prot.

Tiranë, më 24.02.2020

Vendim

Nr. 17 datë 21 shkurt 2020  
Për amendimin e nenit 42 të Statutit

Asambeja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 21 shkurt 2020, në përmbushje të pikës 3 të rendit të ditës, shtuar me propozim të 8 anëtarëve të Asamblesë dhe miratuar prej saj në fillim të mbledhjes (kërkesa dhe amendamenti bashkëngjitur); duke konsideruar se ndryshimi për rritjen e numrit të pjesëmarrësve të jashtëm në komisione është shprehje e hapjes së institucionit ndaj bashkësisë kërkimore dhe universitare të vendit dhe i shërben fuqizimit të misionit të saj, pas diskutimeve, me votim të hapur:

Vendosi:

1. Neni 42 i Statutit të amendohet sipas formulimit të propozuar nga 8 anëtarë të Asamblesë (kërkesa dhe amendamenti bashkëngjitur).
2. Ngarkohen kryetarët e komisioneve dhe kryetarët e seksioneve për zbatimin e këtij ndryshimi statutor.
3. Punonjësi i marrëdhënieve me publikun dhe me jashtë dhe shërbimi IT të bëjnë të njohur në faqen zyrtare të institucionit ndryshimin në Statut.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI